



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228585

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05406497

C.nr.144/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B...me seli në Prishtinë, rr. ..., kundër të paditurit B.T nga Vushtrria, rruga ..., të cilin e përfaqëson me autorizim Av. I.Z nga Vushtrria, me objekt kontesti Rimbursim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia C.nr.144/17 e datës 30.03.2017, e paditëses B...me seli në Prishtinë, rruga ... kundër të paditurit B.T nga Vushtrria, rruga ..., me objekt kontesti Rimbursim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja B...me seli në Prishtinë, rr. ..., në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit B.T nga Vushtrria, rruga ..., me bazë juridike-Rimbursim dëmi.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 04.03.2024, nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 14.02.2024, po ashtu nuk ka prezantuar përfaqësuesi i të paditurit, i cili me parashtrësën e datës 01.03.2024, ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e seancës me arsyetimin se nuk mund të prezantojë i padituri për shkaqe shëndetësore, dhe nga kjo arsye ka kërkuar caktimin e një seance tjetër.

Meqenëse, paditësja B....përkundër ftesës me rregull, nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, konsiderohet se e ka tërhequr padinë kundër të paditurit B.T.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.144/17, me datë 04.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.